



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 500/5 Prot.

Tiranë, më 20 /06/2016

VENDIM

Nr. 35, datë 20 / 6 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe neneve 80-104 të Kodit të Procedurave Administrative,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "BIRN Albania", ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 500 Prot., datë 04.05.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare*".

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 12.04.2016 ka kërkuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës t'i vihet në dispozicion dokumentet zyrtare/informacion në lidhje me procedurën e bisedimeve për zgjatjen afatit të konçesionit të aeroportit të Rinasit, si më poshtë:

1. Procesverbalet e bisedimeve për rishikimin e kontratës së konçesionit me kompaninë Tirana International Airport për heqjen e ekskluzivitetit të fluturimeve ndërkombëtare.
2. Një arsyetim mbi shkaqet dhe logjikën e marrjes së vendimit për pranimin e marrëveshjes për shtyrjen e afatit të konçesionit me 2 vjet në këmbim të heqjes së klauzolës së ekskluzivitetit.
3. Procesverbalet e takimeve me kompanitë e huaja të interesuara për aeroportin e Kukësit, përfshirë letërkëmbimet mes Ministrisë dhe të interesuarve.
4. Një shpjegim për arsyet se pse nuk është marrë parasysh vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nr. 391, datë 24.12.2015.
5. Një kopje të shkresës nr. 469 Prot., datë 14.12.2015, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për Autoritetin e Konkurrencës.

Me shkresën e datës 29.04.2016, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës i ka kthyer përgjigje kërkuesit duke i sqaruar ndër të tjerat se: "*...kërkesa juaj për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duhet t'i drejtoheni OSHA-së, që përbëhet nga MZHETS dhe MTI, e cila më pas, në përputhje me nenin 34 të Kontratës Konçesionare, të vijojë me trajtimin e kërkesës tuaj.*"

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik/ Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ankuesi pretendon se: "*Përgjigja e MTI përbën refuzim për dhënie informacioni në shkelje me ligjin nr. 119/2014, pasi megjithëse nuk ofron bazë ligjore për*

*refuzimin e dhënies së informacionit, lë të kuptohet se autoriteti kontraktor është i dyfishtë, MZHETS dhe MTI, gjë që nuk e justifikon mosdhënien e informacionit". Në këto kushte ankuesi Qendra "BIRN Albania" kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.*

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me Urdhrin nr. 109 datë 06.05.2016, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës. Pranë këtij autoriteti u depozitua Urdhri i inspektimit administrativ dhe u protokollua me nr. 2306 Prot., datë 09.05.2016.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës "BIRN Albania" është depozituar me email dhe protokolluar me nr. 1885 Prot., datë 15.04.2016 pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si dhe me shkresën e datës 29.04.2016 i ka kthyer një përgjigje kërkuarit.

Lidhur me ankesën e Qendrës "BIRN Albania", u kontaktua me Koordinatorin e të Drejtës për Informim dhe personat përgjegjës. Nga ana e grupit të inspektimit u kërkua vlerësimi i përfaqësuesit të Autoritetit Publik/ Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nëse informacioni i kërkuar, përbën apo jo informacion publik, në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku citohet se "*informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik, dhe nëse po, pse nuk është vënë në dispozicion.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik/ Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës sqaruan se: "*...bazuar në Ligjin nr. 9312 datë 11.11.2004 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Koncesionarit TIA.....", kërkesa e subjektit për t'u informuar do të duhej t'i drejtohej OSHA-së e përbërë nga MZHETS dhe MTI, e më pas këto dy institucione në bashkëpunim me koncesionarin do të vazhdonin trajtimin e kërkesës në përputhje me nenin 34.1 dhe 34.2 të Kontratës së nënshkruar, e cila ka të parashikuar edhe dispozitat e Konfidencialitetit".*  
*"Për sa i përket kërkesës së parashtruar nga Inspektorët e Komisionerit në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana e Qendrës "BIRN Albania" dhe Z. përbën apo jo informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014, sqarojmë se këtë përgjigje do t'a japim pas diskutimit me OSHA-në dhe Koncesionarin."*

Pas inspektimit të kryer, me shkresën nr. 1885/1 Prot., datë 09.05.2016, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës i ka dërguar kërkesën e Qendrës "BIRN Albania" dhe Z. për bashkë-trajtim Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "*Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ..... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seancë dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Me shkresën nr. 500/1 Prot., datë 02.06.2016, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 10.06.2016, ora 12:00 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Në seancën dëgjimore u paraqit ankuesi, Qendra "BIRN Albania" e përfaqësuar nga Z. dhe Z. dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës përfaqësuar me autorizimin nr.2893/2 prot., datë 10.06.2016 nga Z. Drejtor i Drejtorisë së*

Projekteve pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Z. \_\_\_\_\_, drejtor i drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe Znj. \_\_\_\_\_ me detyrë Koordinatore për të Drejtën e Informimit. Gjatë seancës dëgjimore Palët e sipërcituara paraqitën pretendimet e tyre.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës sqaron se dokumentacioni që kërkon Qendra "BIRN Albania" nuk mund t'i vihet në dispozicion pa marrë aprovimin e shkruar të Organit të Autorizuar Shtetëror.

Gjatë procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit konstatoi se Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës disponon informacion në lidhje me pikën "1" "3" dhe "5" të kërkesës, konkretisht "*Procesverbalet e bisedimeve për rishikimin e kontratës së koncesionit me kompaninë Tirana International Airport për heqjen e ekskluzivitetit të fluturimeve ndërkombëtare, procesverbalet e takimeve me kompanitë e huaja të interesuara për aeroportin e Kukësit, përfshirë letërkëmbimet mes Ministrisë dhe të interesuarve dhe Një kopje të shkresës nr. 469 Prot., datë 14.12.2015, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për Autoritetin e Konkurrencës*" ndërsa lidhur me pikën 2 dhe 4 ky institucion nuk disponon asnjë informacion apo dokumentacion.

Në lidhje me pikën 1 të kërkesës, në nenin 34 të Kontratës Koncesionare janë të parashikuara dispozitat e Konfidencialitetit ku përcaktohet në mënyrë të qartë se:

#### *34. Konfidencialiteti.*

*34.1 Shtrirja e Konfidencialitetit secila nga Palët do të trajtojë si konfidenciale të gjithë dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me Projektin qofshin këto në formë të shkruar apo gojore, qofshin teknike apo tregtare, që u janë dhënë atyre nga çdo palë ose në emër të cilësdo palë tjetër në këtë Kontratë, dhe nuk duhet as t'ja bëjë të ditur një palë të tretë të gjithë apo pjesë të dokumentit dhe informacionit, as t'ja komunikojë pa pranimin e shkruar të palës tjetër apo në përputhje me Ligjet e tjera të Zbatueshme, rregulloret e çdo burse ndërkombëtare apo praktika të njohura procedurale, (përfshirë këtu rastin e informacionit që i jepet Huadhënësit) përveçse për qëllimet e përmbushjes të kushteve të kësaj Kontrate.*

*34.2 Dhënia e Lejuar e Informacionit Pavarësisht nga Pika 34.1 (Shtrirja e Konfidencialitetit), Shoqëria, Ortakët dhe shoqëritë e tyre mëmë, kanë të drejtë të lejojnë dhënien e informacionit: a) nëqoftëse shihet e nevojshme sipas Ligjit të Zbatueshëm, b) Huadhënësit (duke përfshirë cilindo nga punonjësit, këshilltarët dhe kontraktorët e tij, autoritetet rregullatore, autoritetet e taksave dhe kompanitë mëmë sipas rastiit), ose c) cilindo prej punonjësve, këshilltarëve ose kontraktorëve të saj, d) filialeve të tyre respektive (pasi të jetë marrë më parë aprovimin e shkruar i Organit të Autorizuar Shtetëror) të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera që shihen të nevojshme ose për qëllimin e përmbushjes të detyrimeve të kësaj Kontrate, por në çdo rast ata nuk do të japin shkas apo lejojnë këta persona të ekspozojnë çdo dokument apo informacion të vënë në dispozicion të tyre përveç se atyre që do të shihen të nevojshme për përmbushjen e detyrimit.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, bazuar në nenin 17, pika b) të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ky informacion nuk mund t'i vendoset në dispozicion kërkuar. Për sa i përket pikës 3 dhe 5 të kërkesës, Autoriteti Publik/ Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës duhet të vendosi në dispozicion informacionin që disponon në përputhje me Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar; Ligjin nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, duke respektuar në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, sekretet tregtare ose të drejtat e tjera ekskluzive të parashikuara

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e

lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “BIRN Albania” dhe Z. ndaj Autoritetit Publik/Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “BIRN Albania”, Nr. 500 Prot., datë 04.05.2016, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare” dhe urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar *Procesverbalet e takimeve me kompanitë e huaja të interesuara për aeroportin e Kukësit, përfshirë letërkëmbimet mes Ministrisë dhe të interesuarve*, si edhe *Një kopje të shkresës nr. 469 Prot., datë 14.12.2015, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për Autoritetin e Konkurrencës (pika 3 dhe 5) brenda datës 30. 6.2016.*
2. Rrëzimin e ankesës lidhur me pikën e parë të kërkesës për *procesverbalet e bisedimeve për rishikimin e kontratës së koncesionit me kompaninë Tirana International Airport për heqjen e ekskluzivitetit të fluturimeve ndërkombëtare.*
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 20. 6.2016.

Besnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI

